


STUDIMI PËR POLITIKAT PUBLIKE PËR ZVOGËLIMIN E RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NË KONTEKSTIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



IMPRESSUM

Titulli: **Politikat publike për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Botuesi: **United Nations Development Programme North Macedonia (UNDP North Macedonia)**

Redaktuar nga: **Vasko Popovski, magjistër i shkencave**

Publikuar në: **Prill 2023**



Studimi për politikat publike ishte realizuar si pjesë e programit të udhëhequr nga Njësia për prosperitet gjithëpërfshirës në UNDP CO, Maqedoni e Veriut.

Mbështetja financiare për realizimin e këtij hulumtimi ishte siguruar nga Partneriteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (UNPRPD) Fondi shumëpartnerësh i mirëbeisimit (MPTF), megjithatë nuk pasqyron domosdoshmërisht pozitën zyrtare të UNPRPD MPTF.

Ky publikim mund të përdoret lirisht për qëllime jo-komerciale, të përdorimit të drejtë, me njohjen e duhur të partnerëve dhe UNPRPD MPTF.

Mirënjohje për Organizatat nacionale të personave me aftësi të kufizuara për pjesëmarrjen e tyre domethënëse dhe kontributin e tyre në harmonizimin e studimit me Konventën e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (UNCPRD).

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Profili i rrezikut të Maqedonisë së Veriut karakterizohet nga ndikimi i një sërë rreziqesh natyrore dhe të bëra nga njeriu dhe dominohet nga përmbytjet, tërmetet, temperaturat ekstreme, stuhitë, rrëshqitjet e tokës, thatësitat, epidemitë dhe incidentet tekniko-teknologjike. Pasojat e tyre dëmtojnë seriozisht rezistencën e shoqërisë dhe komuniteteve, thellojnë dobësitë ekzistuese dhe krijojnë pabarazi të reja sociale. Me ndikimet e parashikuara të ndryshimit të klimës, shkallën e degradimit të mjedisit jetësor, urbanizimin intensiv, rreziqet dhe kërcënimet e reja dhe në zhvillim dhe pasojat afatgjata të krizës me pandeminë COVID-19, madhësia e këtyre ngjarjeve pritet të rritet, duke prekur në mënyrë të pabarabartë grupe të ndryshme të popullsisë, ku njerëzit me aftësi të kufizuara vuajnë pasojat më të mëdha. Personat me aftësi të kufizuara mbajnë barrën më të rëndë të ndikimeve të fatkeqësive, si për shkak të karakteristikave dhe rreziqeve të tyre, ashtu edhe për shkak të përjashtimit të tyre shumë të shpeshtë nga politikat dhe praktikave pamjaftueshme për gjithëpërfshirjen e tyre në zvogëlimin e rrezikut dhe përforcimin e përpjekjeve për rezistencë. Për të përmirësuar gjithëpërfshirjen e aftësisë së kufizuar në zvogëlimin gjithëpërfshirës të rrezikut nga fatkeqësitë, Studimi për politikat publike mbështet ndërtimin e rezistencës të shoqërisë dhe komuniteteve duke kuptuar marrëdhëniet midis aftësisë së kufizuar dhe kornizës së zvogëlimit të fatkeqësive, rishikimin e kontekstit ekzistues përmes identifikimit të hendqeve, sfidave dhe praktikave të mira mbizotëruese dhe duke formuluar rekomandime të ardhshme.

Nga analiza, u përcaktua se të dy sistemet, për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirjen e aftësisë së kufizuar, nuk janë mjaft të ndërlidhura, pasi themelet e të dyjave nuk janë mjaft të integruara në strukturat dhe proceset e tyre. Ashtu si në shumë politika dhe praktika të tjera sektoriale, personat me aftësi të kufizuara janë ende “të padukshëm” dhe perceptohen si një grup i popullsisë më të gjerë të rrezikuar në vend. Rrjedhimisht, ato nuk janë pjesë e narrativës për zvogëlimin e rreziqeve të klimës dhe fatkeqësive dhe nuk kanë qasje të drejtë në proceset e hartimit të politikave dhe vendimeve dhe zbatimit të masave dhe aktiviteteve për të ndërtuar rezistencën e shoqërisë dhe komuniteteve. Qasja e përgjithshme për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend është ende kryesisht reaktive dhe jo proaktive, me theks të veçantë në reagimin dhe jo parandalimin dhe zbutjen. Në këtë kontekst, si Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ashtu edhe politikat përkatëse nuk njihen sa duhet si bazë për ndërtimin e qëndrueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara përmes zhvillimit të politikave dhe rregulloreve gjithëpërfshirëse, si dhe krijimin e praktikave dhe veprimeve gjithëpërfshirëse.

Duke u bazuar në analizën e kryer, si dhe kornizat dhe mekanizmat ekzistues globalë dhe rajonale për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent dhe gjithëpërfshirje sociale që kërkojnë përfshirje dhe pjesëmarrje më të madhe të personave me aftësi të kufizuara në krijimin dhe miratimin e politikave dhe rregulloreve, ky dokument ofron grupin e mëposhtëm të rekomandimeve për periudhën në vijim. Ato përfshijnë përmirësimin dhe modifikimin e kornizës politike dhe normative, përforcimin e arkitekturës institucionale, rritjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre, formulimin e praktikave të përmirësuar gjithëpërfshirëse, përmirësimin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave të ndara për aftësinë e kufizuar, përmirësimin e qasjes në informacione dhe komunikimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe investimin në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë duke përfshirë aftësinë e kufizuar dhe rimëkëmbjen e rrezikuar të personave me aftësi të kufizuara.

SHKURTESAT

CMC	Qendra për menaxhim të krizave
CMS	Sistemi i menaxhimit të krizave
CMW	Komisioni për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre
CRPD	Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
CRPD	Komisioni për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
DRM	Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë
DRR	Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë
EU	Bashkimi Evropian
GFDRR	Instrumenti global për zvogëlimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë
GIS	Sistemi i informacionit gjeografik
HRC	Këshilli për të drejtat e njeriut
IFES	Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore
UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PDNA	Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë
PwDs	Personat me aftësi të kufizuara
SDGs	Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm
ODIHR	Zyra për institucionet demokratike dhe të drejtat njeriut
PRD	Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim
SDG	Qëllimi për zhvillim të qëndrueshëm
Sendai Framework	Korniza Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015 - 2030
UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNDRR	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNPRPD	Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara
WHO	Zyra e Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë
	Partneriteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
	Organizata botërore e shëndetësisë

PËRMBAJTA

1. HYRJE	1
1.1. Profili i rrezikut të përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut.....	1
1.2. Kush është më i ekspozuar ndaj rrezikut në vend?	2
1.3. Qëllimi i këtij dokumenti.....	4
1.4. Korniza për përgatitjen e Studimit të politikave publike	5
1.5. Qasja dhe korniza metodologjike	5
2. KORNIZA GLOBALE E QËNDRUESHME DHE REZISTENTE DHE PËRFSHIRJA E AFTËSISË SË KUFIZUAR NË ZVOGËLIMIN E RREZIKUT NGA FATKEQËSITË.....	6
2.1. Korniza Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015 – 2030	6
2.2. Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm (QZHQ)	7
2.3. Marrëveshja e Parisit.....	8
2.4. Forumi evropian për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë	9
2.5. Habitat III – Agjenda e re urbane	10
2.6. Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	10
2.7. Rezoluta e Këshillit të OKB-së për të drejtat e njeriut.....	14
2.8. Harmonizimi i Maqedonisë së Veriut me kornizën globale të qëndrueshme dhe rezistente	14
3. KONTEKSTI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NË MAQEDONINË E VERIUT NË LIDHJE ME PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	17
3.1. Kuadri politik dhe rregullator i sistemeve kombëtare të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirjes së aftësive të kufizuara.....	17
3.2. Arkitektura institucionale e sistemeve kombëtare të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirjes së aftësisë së kufizuar	22
3.2.1. Korniza institucionale për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend.....	22
3.2.2. Korniza institucionale për ndryshimin klimatik në vend.....	23
3.2.3. Korniza institucionale për menaxhimin e tokës, planifikimin hapësinor dhe urban	24
3.2.4. Korniza institucionale e sistemit të gjithëpërfshirjes së aftësisë së kufizuar	24

4. HENDEQET E SISTEMIT, SFIDAT DHE PRAKTIKAT E MIRA NË PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KORNIZËN KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË.....	26
4.1. Hyrje.....	26
4.2. Hendeqet dhe sfidat për menaxhimin kombëtar të rrezikut nga fatkeqësitë, duke përfshirë aftësinë e kufizuar.....	27
4.3. Praktikrat e mira dhe mësimet e nxjerra në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend .	38
5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET LARGPAMËSE.....	46
ANEKSI 1 - Kush është i rrezikuar në Maqedoninë e Veriut dhe Pse?....	53
BIEBLOGRAFIA.....	57


1. HYRJE

1.1. Profili i rrezikut të përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut

Profili i rrezikut të Maqedonisë së Veriut karakterizohet nga ndikimi i një sërë rreziqesh natyrore dhe të bëra nga njeriu dhe dominohet nga përmytjet, tërmetet, temperaturat ekstreme, stuhitë, rrëshqitjet e tokës, thatësi, epidemitë dhe incidentet tekniko-teknologjike. Përmytjet janë më të shpeshta me intensitetin dhe madhësinë më të lartë; ngjarjet e lidhura me motin janë në rritje me madhësi më të mëdha; zjarret po rriten në frekuencë dhe pasoja për natyrën dhe biodiversitetin, ndërsa tërmetet kanë ndikimin më të madh potencial për sa i përket humbjes së jetës dhe dëmtimeve dhe humbjeve afatgjata.

Sipas Instrumentit global për zvogëlimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, popullsia mesatare vjetore e prekur nga përmytjet është rreth 70,000 dhe prodhimi i brendshëm bruto vjetor i prekur është 500 milion dollar amerikan, ndërsa popullsia mesatare vjetore e prekur nga tërmetet është 40,000 dhe prodhimi i brendshëm bruto vjetor i prekur është 200 milion dollarë amerikan¹. Sipas të dhënave të disponueshme për fatkeqësitë e kaluara, gjatë dy dekadave të fundit, në 14 fatkeqësi, kishte 79 viktima njerëzore, përafërsisht 1.3 milion banorë u prekën dhe vetëm tetë fatkeqësi kishin një çmim prej gjysmë miliard dollarësh amerikan. Shumica e viktimave njerëzore u regjistruan gjatë përmytjes së rrëmbyeshme të tokës në Shkup në gusht të vitit 2016 (22), zjarret në korrik të vitit 2007 prekën pothuajse gjysmën e popullsisë (1.000.000 banorë) dhe përmytjet në vitin 1995 kishin dëmet më të larta prej 245 milionë USD. Për më tepër, shumë ngjarje katastrofike në shkallë të vogël po ushtrojnë presion kronik mbi strukturën rezistente të shoqërisë dhe komuniteteve duke shteruar burimet e tyre të fundme.

Figure 1. Pasqyrë e rritjes së temperaturës në Maqedoninë e Veriut në periudhën e viteve 1850 -2022²



¹ Global Forum for Disaster Reduction and Recovery. *North Macedonia section*. 2017. <https://tinyurl.com/47pdmfar>

² Ed Hawkins. University of Reading. Në dispozicion në: <https://showyourstripes.info/l/europe/northmacedonia/all>

Kjo prirje pritet të rritet më tej në të ardhmen duke pasur parasysh rritjen e temperaturës (shih Figurën 1), ndikimin e pritshëm të ndryshimit të klimës dhe pas analizës së parashikimeve të ndryshimeve klimatike dhe ngjarjeve ekstreme³. Vendi do të përballet me klimë më të ngrohtë dhe më të thatë në të ardhmen me shfaqjen në rritje të ngjarjeve ekstreme të ngrohta dhe zvogëlimin e numrit të ngjarjeve ekstreme të ftohta. Nga ana tjetër, kushtet më të thata do të rezultojnë në një rritje të mundshme të reshjeve ekstreme duke rezultuar në rrezik më të madh të përmytjeve të shpejta. Zvogëlimi i pritshëm i reshjeve të verës dhe vazhdimi i kohëzgjatjes së mëvonshme do të rrisë rrezikun e shfaqjes së thatësirave, periudhave të zgjatura të bimësisë dhe numrit më të madh të zjarreve. Për shkak të përkeqësimit të kushteve të mjedisit jetësor, urbanizimit intensiv, etj., pritet të ketë një rritje të frekuencës, intensitetit dhe ndikimit të ngjarjeve të fatkeqësive që do të ndikojnë ndjeshëm në rezistencën e përgjithshme të vendit dhe komuniteteve lokale, veçanërisht duke prekur grupet e rrezikuara të qytetarëve.

Në të njëjtën kohë, në vitet e fundit, ne jemi përballur me rreziqe dhe kërcënime të reja, përkatësisht krizën e emigrantëve dhe refugjatëve që nga viti 2015, ndotjen e ajrit në Shkup dhe qytete të tjera të mëdha në të gjithë vendin dhe krizën pandemike me KOVID-19. Pandemia me KOVID-19 ishte fatkeqësia më e madhe (shëndetësore) e kohës sonë gjatë së cilës, në periudhën midis 03 janarit 2020 dhe 26 prillit 2023 pati 348,059 raste të konfirmuara, 9,672 vdekje dhe humbje kumulative të prodhimit për vitin 2020 dhe 2021 prej 3.7 miliardë dollarë⁴. Ndikimi jashtëzakonisht i fuqishëm i krizës pandemike me KOVID-19 kontribuoi në krijimin e “*të varfërve të rin dhe të rrezikuarve të rinj*” (njerëzit, veçanërisht nga qendrat urbane, që po përjetojnë dobësi për herë të parë si rezultat i krizës), shfaqjen e formave të reja të pabarazisë sociale dhe një rritje të rasteve të dhunës në familje⁵.

1.2. Kush është më i ekspozuar ndaj rrezikut në vend?

Në përgjithësi, emergjencat, fatkeqësitë dhe krizat ndikojnë në të gjithë popullsinë ndryshe me ndikime të ndryshme në ekzistencën dhe zhvillimin e tyre të tanishëm dhe të ardhshëm. Prandaj, është e rëndësishme të identifikohet se cilat kategori të qytetarëve janë më të rrezikuar në Maqedoninë e Veriut. Për këtë qëllim, *Raporti i zhvillimit njerëzor i vitit 2016 nga UNDP-ja - Mbrojtja nga rreziku në Ballkanin Perëndimor: Fuqizimi i njerëzve për të parandaluar fatkeqësitë*⁶ identifikon grupin thelbësor të shtatë popullatave të rrezikuara arketipike: njerëzit e varfër, gratë, fëmijët dhe të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, pakicat, migrantët, të kthyerit dhe personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) dhe fermerët. Pasqyra e grupit thelbësor të popullsisë të rrezikuara është paraqitur në Aneksin 1 të këtij dokumenti. Kjo ndarje nuk është shteruese, pasi ka grupe më gjithëpërfshirëse që identifikojnë dhe përfshijnë grupe shtesë, të tilla si familjet me një prind, pakicat seksuale dhe gjinore, grupe të tjera të marginalizuara, etj. Megjithatë, shkaqet rrënjësore të rrezikueshmërisë së tyre ndaj fatkeqësive natyrore (nxitësit/faktorët e rrezikut) mund të identi-

³ Gjurgjeviq, Vladimir. *Raporti i projeksionit për ndryshimet klimatike dhe ndryshimet në ngjarjet ekstreme klimatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. UNDP 2020. f. 4. [online] Në dispozicion në <https://tinyurl.com/yc3r4yaa>

⁴ UNDP. *Vlerësimi social dhe ekonomik i ndikimit të KOVID-19 në Maqedoninë e Veriut*. UNDP Qershor 2020. f. 8. Në dispozicion në: <https://www.impact-covid19.mk/>

⁵ <https://tinyurl.com/3z86sdce>

⁶ UNDP. *Raporti i zhvillimit njerëzor 2016 - Mbrojtja ndaj rrezikut në Ballkanin Perëndimor: Fuqizimi i njerëzve për të parandaluar fatkeqësitë*. 2016. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/yc548e2v>

fikohen në disa zona të ndërlidhura, p.sh. konteksti gjeografik dhe ekspozimi ndaj rreziqeve, karakteristikat socio-ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera, niveli i njohurive dhe arsimit, qasja në shërbime, pjesëmarrja në proceset e politikave dhe vendimmarrjes, siguria dhe drejtësia, etj.

Njerëzit me ndonjë formë të aftësisë së kufizuar përbëjnë të paktën 15% të popullsisë globale, nga të cilët 2-4% përjetojnë vështirësi të konsiderueshme në funksionim. Prevalenca globale e aftësisë së kufizuar është më e lartë se vlerësimet e mëparshme të Organizatës botërore të shëndetësisë, të cilat datojnë nga vitet 1970 dhe sugjeruan një shifër prej rreth 10%.⁷ “Çështja e aftësisë së kufizuar, pavarësisht se ishte pjesë e Regjistrimit të popullsisë në vitin 2021, nuk dha një pasqyrë të qartë të numrit të përgjithshëm të popullsisë me aftësi të kufizuara. Sipas rezultateve të regjistrimit, në vend ka gjithsej 94,412 persona me aftësi të kufizuara, që përfaqëson pothuajse 5% të popullsisë së përgjithshme, nga të cilat 2.5% janë njerëz mbi 65 vjeç.”⁸ Nga ana tjetër, nëse aplikohet shifra prej 15%, atëherë në nivel nacional në Maqedoninë e Veriut mund të vlerësohet se rreth 276,000 qytetarë përjetojnë një formë të aftësisë së kufizuar. “Personat me aftësi të kufizuara janë të rrezikuar për shkak të sfidave fizike, varësisë nga të tjerët dhe zvogëlimit të ndihmës publike. Ndërsa personat me aftësi të kufizuara janë shpesh një grup më i rrezikuar i popullsisë, nivelet dhe llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara (fizike, intelektuale, mendore, shqisore, të kombinuara) përgjithësojnë rrezikueshmërinë e tyre ndaj rreziqeve të fatkeqësive në mënyrë të vështirë.”⁹

Personat me aftësi të kufizuara po mbajnë barrën më të rëndë nga ndikimet e krizave dhe fatkeqësive, si për shkak të karakteristikave të tyre dhe dobësive mbizotëruese, ashtu edhe për shkak të përjashtimit shumë të shpeshtë nga politikat e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe praktikave të pamjaftueshme gjithëpërfshirëse të zvogëlimit të rrezikut. Ka shumë shembuj në botë që e tregojnë këtë situatë. Për shembull, hulumtimet tregojnë se shkalla e vdekshmërisë në mesin e personave me aftësi të kufizuara ka tendencë të jetë dy deri në katër herë më e lartë se ajo e pjesës tjetër të popullsisë, siç demonstron gjatë tërmetit dhe cunamit të Japonisë në vitin 2011 dhe Uragani Katrina në SHBA¹⁰. Statistikat e Mbretërisë së Bashkuar nga fillimi i vitit 2021 tregojnë tashmë se personat me aftësi të kufizuara përbënin gjashtë në 10 vdekje të lidhura me KOVID-19.¹¹ Rrjedhimisht, kjo prirje mund të gjendet në ngjarje të tjera fatkeqësie, p.sh. përmytje¹² ose zjarre¹³. Nga ana tjetër, përmytjet e majit 2014 në Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë prekën ndjeshëm personat me aftësi

“Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë të meta afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të efektshme në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.”

Burimi: Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (neni 1)

<https://tinyurl.com/4znzhshd>

⁷ <https://tinyurl.com/3m4tdkum>

⁸ MPPS - Ministria e punës dhe politikës sociale. *Draft strategjia kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2023-2030 me Planet e veprimtimit 2023-2026*. 2023. f. 15. Në dispozicion në: <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detailid=61>

⁹ UNDP Raporti i zhvillimit njerëzor 2016 - Mbrojtja ndaj rrezikut në Ballkanin Perëndimor: Fuqizimi i njerëzve për të parandaluar fatkeqësitë. 2016. f. 66. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2ex2vx2f>

¹⁰ Panel diskutimi mbi rezistencën dhe aftësinë e kufizuar ndaj fatkeqësive: Sigurimi i barazisë dhe përfshirjes. Dhoma ECOSOC, OKB (2013). Në dispozicion në: https://www.un.org/disabilities/documents/reports/iddr2013_%20panelreport.pdf

¹¹ Raporti evropian për të drejtat e njeriut. *Ndikimi i KOVID-19 mbi personat me aftësi të kufizuara*. Forumi evropian i aftësisë së kufizuar (2021). Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2t8xvtxs>

¹² <https://tinyurl.com/yckrvh45>

¹³ <https://tinyurl.com/t7dk9uav>

të kufizuara dhe pakicat. Të parët vuajtën për shkak të reagimit joefikas të menjëhershëm dhe shërbimeve të dobëta të shpëtimit që rezultuan nga mungesa e sistemeve adekuate të paralajmërimit të hershëm dhe standardeve dhe protokolleve të shpëtimit dhe njohurive të dobëta të institucioneve dhe forcave të shpëtimit për nevojat e tyre të menjëhershme dhe të hershme të rimëkëmbjes. Për shembull, në komunën e Svilajnacit, evakuimi i popullatës nuk u krye dhe personat me aftësi të kufizuara u rrezikuan.¹⁴ Gjithashtu, “*në përmbytjet e vitit 2014, shumë persona me aftësi të kufizuara ose probleme shëndetësore para-ekzistuese u evakuuan pa pajisjet e tyre të nevojshme mjekësore, përshkrimet ose dokumentacionin, gjë që i vendosi ata në një pozitë më të ndjeshme.*”¹⁵

Në Maqedoninë e Veriut, ka pasur disa ngjarje të fatkeqësive ku viktimat ishin persona me aftësi të kufizuara, si dhe kategori të tjera të prekshme, p.sh. gra, të rinj dhe të moshuar. Duke marrë parasysh të parën, përmbytjet e shpejta në dhjetor të vitit 2008 në Radovich dhe Konçe shkaktuan humbjen e dy personave me aftësi të kufizuara, ndërsa në përmbytjet e shpejta në Tetovë në gusht të vitit 2015 dhe Shkup, një vit më vonë, shumë prej viktimave ishin nga grupet e rrezikuara të qytetarëve. Përrjashtimi nga narrativa e integruar e reduktimit të rrezikut, d.m.th. nga politikat, proceset dhe praktikat, kontribuon gjithashtu në këtë inekzistencë të gjithëpërfshirjes në ndërtimin e rezistencës të shoqërisë, komuniteteve dhe njerëzve. Në përgjithësi, shumë sisteme të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, në nivel global dhe rajonal, janë “*të verbër*” ndaj reduktimit të rrezikut gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm, pa ofruar mundësi për pjesëmarrje kuptimplote dhe ndërtimin e rezistencës të personave me aftësi të kufizuara bazuar në nevojat, njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Duke marrë parasysh atë që është thënë më sipër dhe përpjekjet për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, rezistent dhe gjithëpërfshirës, është e nevojshme të konceptohet dhe të integrohet reduktimi i rrezikut të aftësisë së kufizuar në të gjithë sistemin e menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive, duke mundësuar jo vetëm pjesëmarrje më të madhe të personave me aftësi të kufizuara, por edhe ndërtimin gjithëpërfshirës të rezistencës të tyre ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese dhe atyre në zhvillim. Për këtë qëllim, pika e nisjes është të kuptohet më mirë përfshirja e aftësisë së kufizuar në politikat, programet dhe shërbimet e zvogëlimit të rrezikut që janë në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare. Prandaj, objektivi i kësaj detyre kërkimore është të kryejë një rishikim të vendit mbi gjendjen aktuale të përfshirjes së aftësisë së kufizuar në politikat dhe praktikat e lidhura me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

1.3. Qëllimi i këtij dokumenti

Qëllimi kryesor i *Studimit të politikave publike për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut* është të mbështesë përpjekjet për ndërtimin gjithëpërfshirës të qëndrueshmërisë në vend përmes një kuptimi të kuadrit të aftësisë së kufizuar dhe zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, rishikimit të kontekstit aktual me identifikimin e hendeqeve dhe sfidave ekzistuese dhe praktikave të mira, pasuar nga formulimi i rekomandimeve të ardhshme. Gjithashtu, ky Studim i politikave publike synon të

¹⁴ OSBE. *Rodna analiza uticaja poplava u Srbiji u 2014 godini*. f.19. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2m3vht8b>

¹⁵ UNICEF. *Analiza Klimatske Situacije u Njenih Uticaja Na Decu U Srbiji*. UNICEF. Shtetor 2021. p. 31. Në dispozicion: <https://www.unicef.org/serbia/media/18356/file/CLAC%20izvestaj.pdf>

kontribuojë në një ndryshim transformues në të kuptuarit dhe përfshirjen praktike të aftësisë së kufizuar në ndërtimin e rezistencës të shoqërisë dhe komuniteteve ndaj krizave dhe fatkeqësive.

1.4. Korniza për përgatitjen e Studimit të politikave publike

Për zbatimin e kësaj detyre, u përcaktua një qasje e përshtatshme dhe kornizë metodologjike sipas lëndës së hulumtimit, qëllimeve dhe specifikave të saj, si dhe parametrave të përshtatshëm të studimit të politikave publike që janë bazë e këtij procesi.

Table 1. Parametrat e Studimit të politikave publike (Autori)

Parametrat	Përshkrimi
Relevanca	Shkalla në të cilën politikat dhe praktikat gjithëpërfshirëse të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë janë integruar në sistemin kombëtar të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë.
Përgjigje	Roli dhe përgjegjësitë e subjekteve në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, para dhe pas fatkeqësive, duke marrë parasysh nevojat dhe aftësitë e personave me aftësi të kufizuara.
Efektiviteti	Një masë e shkallës në të cilën sistemi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë po përmbush mandatin e tij dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe monitoron nëse janë arritur rezultatet e pritshme.
Ndikimi	Ndikimet pozitive dhe/ose negative të sistemit të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë në rezistencën e personave me aftësi të kufizuara, si të drejtpërdrejta ashtu edhe/ose të tërthorta.
Mësimet e nxjerra/rekomandimet	Identifikimi i mësimave të nxjerra dhe mënyra e veprimit për atë se si politikat dhe praktikat gjithëpërfshirëse duhet të integrohen në menaxhimin kombëtar të rrezikut nga fatkeqësitë.

1.5. Qasja dhe korniza metodologjike

Qasja dhe kornizat metodologjike janë përmbledhëse dhe përdorin një përzierje të mjeteve cilësore dhe sasiore. Përgatitja e këtij studimi përfshinte mjetet e mëposhtme: *Analiza e Përmbajtjes* (është përdorur gjatë fazës fillestare të detyrës me rishikimin dhe analizën e përmbajtjes së të gjitha materialeve, dokumenteve, raporteve dhe informacionit në dispozicion), *Analiza krahasuese* (gjatë shqyrtimit të materialeve dhe dokumenteve), *Dizajni i hulumtimit* të kombinuar cilësor/sasior (gjatë pjesës së mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave nga informuesit kryesorë me përdorimin e një pyetësori dhe intervista gjysmë të strukturuar dhe konsultime me përfaqësuesit kryesorë nga subjektet) dhe *Dizajni i hulumtimit* cilësor (gjatë identifikimit dhe kodifikimit të mësimave të nxjerra dhe praktikave të mira). Metoda e trekëndëshit u përdor për të verifikuar informacionin e mbledhur gjatë procesit të shqyrtimit të përmbajtjes, rishikimit të dokumenteve, pyetësorit në internet, intervistave kryesore të informuesve dhe vlerësimit gjatë diskutimeve me përfaqësuesit

e ekipit. Qëllimi ishte të vërtetohej informacioni dhe të dhënat në një mënyrë të strukturuar përmes verifikimit nga burime të shumta të të dhënave.

Kufizimet mund t'i referohen afatit kohor për realizimin e detyrës hulumtuese, efekteve gjatësore (disponueshmëria kohore e të anketuarve ose disponueshmëria e informuesve kryesorë), afateve kohore të përgjigjeve në anketën online, lodhjes së të anketuarve dhe informuesve për të marrë pjesë në anketë dhe intervista, sepse për shumë anketa në internet që janë kryer gjatë pandemisë, prevalenca e KOVID-19, qasja në informacion dhe të dhëna, qasja e kufizuar në vlerësimet dhe planet e rrezikut dhe çështjet e mundshme të privatësisë së të dhënave.

2. KORNIZA GLOBALE E QËNDRUESHME DHE REZISTENTE DHE PËRFSHIRJA E AFTËSISË SË KUFIZUAR NË ZVOGËLIMIN E RREZIKUT NGA FATKEQËSITË



2.1. Korniza Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015 – 2030¹⁶

Korniza Sendai është një kornizë globale për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, e miratuar në Konferencën e tretë botërore e OKB-së për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, që u mbajt në Sendai, Japoni, në mars të vitit 2015. *Objektivi kryesor është zvogëlimi substancial i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe humbjet në jetë, jetesë dhe shëndet në pasuritë ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe ekologjike të personave, bizneseve, komuniteteve dhe vendeve.* Korniza Sendai krijon terren bashkëkohor të zhvillimit rezistent të shteteve dhe territoreve në nivel global përmes një ndryshimi të paradigmës nga menaxhimi i fatkeqësive në menaxhimin e rrezikut të katastrofave të rreziqeve ekzistuese dhe të ardhshme duke sjellë ndërtimin e rezistencës si qëllimin kryesor që duhet të arrihet deri në vitin 2030. Ai ka shtatë synime dhe katër përparësi për veprim që kontribuojnë në parandalimin e rreziqeve të reja dhe zvogëlimin e rreziqeve ekzistuese përmes integritit të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në të gjithë sektorët, programet dhe politikat e zhvillimit. Ndërsa Korniza Sendai është një marrëveshje vullnetare, jo-detyruese, ajo bën thirrje për një angazhim të të gjithë shoqërisë, me qeveritë që kanë rolin kryesor të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

Katër prioritete i referohen kuptimit të rrezikut, rritjes së rregullimit të rrezikut nga fatkeqësitë, investimit në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë për arritjen e qëndrueshmërisë dhe rritjen e gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes ndaj fatkeqësive. Përveç kësaj, brenda këtyre katër prioriteteve, ekzistojnë 39 parime udhëzuese dhe dy prej tyre i referohen drejtpërdrejt personave me aftësi të kufizuara, konkretisht:

- (19) (d): *“Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë kërkon një angazhim dhe partneritet të të gjithë shoqërisë. Ai gjithashtu kërkon fuqizim dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, të arritshme dhe jo-diskriminuese, duke i kushtuar vëmendje të veçantë njerëzve të prekur në mënyrë disproporcionale nga fatkeqësitë, veçanërisht më të varfërit. Një perspektivë gjinore, e moshës, aftësisë të kufizuar dhe kulturore duhet të integrohet në të gjitha politikat dhe praktikat, dhe udhëheqja e grave dhe të rinjve duhet të promovohen. Në këtë kontekst, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet përmirësimit të punës së organizuar vullne-*

¹⁶ https://www.unisdr.org/files/43291_sendaiframeworkfordren.pdf

tare të qytetarëve.” dhe

- (19)(g): “Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë kërkon një qasje me shumë rreziqe dhe vendimmarrje gjithëpërfshirëse të informuar për rrezikun bazuar në shkëmbimin e hapur dhe shpërndarjen e të dhënave të ndara, duke përfshirë sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar, si dhe në informacionin e rrezikut lehtësisht të arritshëm, të përditësuar, të kuptueshëm, të bazuar në shkencë, jo të ndjeshëm, të plotësuar nga njohuritë tradicionale.”

Kjo qasje kërkon që zbatimi efektiv i katër prioriteteve për veprim duhet të sigurojë përfshirjen e një perspektive të aftësisë së kufizuar në zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha politikave dhe praktikave të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Prandaj është e rëndësishme të inkurajohet konsultimi dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre për të miratuar me të vërtetë qasjen e parashikuar të të gjithë shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme, miratimi i një qasjeje me shumë rreziqe dhe vendimmarrja e informuar për rrezikun në zbatimin e katër prioriteteve kërkon qasje, përdorim dhe konsideratë të proceseve të shëndosha dhe të besueshme të aftësisë së kufizuar.¹⁷



2.2. Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm (QZHQ)

Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm janë plane për arritjen e një të ardhme më të mirë, më të qëndrueshme dhe rezistente për të gjithë. Me gjithsej 17 qëllime, 169 synime dhe 230 tregues, Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm përqendrohen në tre fusha kryesore: (i) çrrënjosjen e varfërisë; (ii) mbrojtjen e planetit nga degradimi, duke siguruar që përparimi ekonomik, social dhe teknologjik të ndodhë në harmoni me natyrën; dhe (iii) promovimin e paqes universale dhe shoqërive të drejta dhe gjithëpërfshirëse. Në këtë mënyrë, arritja e secilit prej 17 qëllimeve mund të përmirësojë rezistencën e personave me aftësi të kufizuara për t'i bërë ballë katastrofave.¹⁸

Veprimi klimatik dhe zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë janë çështje ndërsektoriale, por përmenden në mënyrë eksplicite në QZHQ 13¹⁹ për adresimin e ndryshimeve klimatike dhe ndikimeve të saj dhe QZHQ 11²⁰ opëri t'i bërë qytetet gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme. Këto dy QZHQ janë të rëndësishme për ata që janë të angazhuar në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë respektivisht QZHQ 11, “duke përfshirë gratë, fëmijët, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara në rrezik, dhe QZHQ 13 gjithashtu promovon ngritjen e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim efektiv të lidhur me ndryshimet klimatike që përfshin gratë, të rinjtë dhe komunitetet lokale dhe të marginalizuara - të gjitha këto do të përfshinin personat me aftësi të kufizuara.”²¹ Për më tepër, ato gjithashtu kontribuo-

¹⁷ Instrumenti global për zvogëlimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë Përfshirja e aftësisë së kufizuar në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë Praktikë dhe mundësitë premtuese për angazhimin e zgjeruar. GFDRR. 2017. f. 26. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3mwta9z6>

¹⁸ Ibid. f.24.

¹⁹ <https://sdgs.un.org/goals/goal13>

²⁰ <https://sdgs.un.org/goals/goal11>

²¹ Instrumenti global për zvogëlimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë Përfshirja e aftësisë së kufizuar në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë

jnë në arritjen e shumë prej qëllimeve të tjera. Nga ana tjetër, pesë Qëllimet përfshijnë drejtpërdrejtë aftësinë e kufizuar dhe janë të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara²², d.m.th. *QZHQ 4* (Garantimi i arsimit të barabartë dhe të arritshëm duke ndërtuar mjedise gjithëpërfshirëse të të mësuarit dhe sigurimin e ndihmës së nevojshme për personat me aftësi të kufizuara)²³, *QZHQ 8* (Promovimi i rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse, punësimit të plotë dhe produktiv që lejon personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të plotë në tregun e punës)²⁴, *QZHQ 10* (Theksimi i përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të personave me aftësi të kufizuara)²⁵, *QZHQ 11* (Krijimi i qyteteve dhe burimeve ujore të arritshme, të përballueshme, të arritshme dhe të qëndrueshme të transportit, sigurimi i qasjes universale në hapësira publike të sigurta, gjithëpërfshirëse, të arritshme dhe të gjelbërta) dhe *QZHQ 17* (Nënvizimi i rëndësisë së mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit të *QZHQ*-ve, theksimi i të dhënave të ndarjes së aftësive të kufizuara)²⁶.



2.3. Marrëveshja e Parisit²⁷

Marrëveshja e Parisit kërkon të rrisë ndjeshëm veprimet klimatike dhe të merret në mënyrë më gjithëpërfshirëse me ndikimet e ndryshimeve klimatike për të mbrojtur zhvillimin dhe eliminimin e varfërisë. Ai synon në mënyrë specifike të zvogëlojë ndjeshëm rreziqet dhe ndikimet e ndryshimit të klimës dhe të nxisë rezistencë ndaj klimës. *“Me rëndësi në këtë kontekst, është pranimi në preambulë se ndryshimi i klimës është një ‘shqetësim për njerëzimin’ dhe se në ndërmarrjen e veprimeve mbi ndryshimin e klimatik, palët duhet të marrin në konsideratë detyrimet e tyre në lidhje me të drejtat e njeriut të njerëzve në situata të rrezikuara, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.”*²⁸ Nenet 7 dhe 8 përqendrohen në mënyrë eksplicite në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë: Neni 7.1, për rritjen e kapacitetit përshtatës, përforsimin e rezistencës dhe zvogëlimin e rrezikueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe Neni 8.1, për shmangien, minimizimin dhe adresimin e humbjes dhe dëmtimit të lidhur me efektet negative të ndryshimit të klimës. Në veçanti, Neni 8 përcakton *“qëllimin global për përshtatjen e rritjes së kapacitetit adaptues, përforsimin e rezistencës dhe zvogëlimin e rrezikueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm.”*²⁹ Prandaj, fushat e bashkëpunimit dhe lehtësimit për të rritur mirëkuptimin, veprimin dhe mbështetjen mund të përfshijnë sistemet e paralajmërimit të hershëm; gatishmërinë për emergjenca; ngjarjet e ngadalta të fillimit; ngjarjet që mund të përfshijnë humbje dhe dëme të pakthyeshme dhe të përhershme; vlerë-

Praktikat dhe mundësitë premtuese për angazhimin e zgjeruar. GFDRR. 2017. f. 24. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3mwta9z6>

²² <https://tinyurl.com/2jzcyuzs>

²³ <https://www.sdg4education2030.org/the-goal>

²⁴ <https://sdgs.un.org/goals/goal8>

²⁵ <https://sdgs.un.org/goals/goal10>

²⁶ <https://sdgs.un.org/goals/goal17>

²⁷ https://unfccc.int/sites/default/files/english_paris_agreement.pdf

²⁸ Instrumenti global për zvogëlimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë Përfshirja e aftësisë së kufizuar në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë Praktikat dhe mundësitë premtuese për angazhimin e zgjeruar. GFDRR. 2017. f. 27. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3mwta9z6>

²⁹ Grupi BP. LIFELINES Mundësia e infrastrukturës rezistente. 2019. f. 27. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2bv7hdmd>

simin dhe menaxhimin gjithëpërfshirës të rrezikut; objektet e sigurimit të rrezikut, grumbullimin e rrezikut klimatik dhe zgjidhje të tjera të sigurimit; humbjet joekonomike; dhe qëndrueshmërinë e komuniteteve, mjeteve të jetesës dhe ekosistemeve. Këto fusha të bashkëpunimit dhe lehtësimit lidhen me prioritetet e Kornizës Sendai dhe qëllimet dhe synimet e QZHQ-ve siç paraqiten në tabelën më poshtë.

Table 2. Lidhja e fushave të bashkëpunimit dhe lehtësimit të nenit VIII me përparësitë e SFDRR dhe qëllimet dhe synimet e QZHQ-ve (Autori)

Marrëveshja e Parisit Neni VIII	Korniza Sendai	QZHQ-të
Sistemet e paralajmërimit të hershëm/Gatishmëria për emergjencë	Prioriteti 4	3, 11, 13
Ngjarje të ngadalshme/Ngjarje që mund të përfshijnë humbje dhe dëme të pakthyeshme dhe të përhershme	Të gjitha prioritetet	1, 2, 13, 15
Vlerësimi dhe menaxhimi gjithëpërfshirës i rrezikut	Prioriteti 1	11, 13, 15
Objektet e sigurimit të rrezikut, bashkimi i rrezikut klimatik dhe zgjidhjet e tjera të sigurimit	Prioriteti 3	13
Humbje joekonomike	Prioriteti 3	1, 2, 11, 13, 14, 15
Rezistenca e komuniteteve, jetesës dhe ekosistemeve	Të gjitha prioritetet	Të gjitha QZHQ-të



2.4. Forumi evropian për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë³⁰

*Udhërrëfyese 2021-2030 për një Evropë rezistente ndaj klimës dhe fatkeqësive dhe Azia Qendrore*³¹ shënon një fazë të re në avancimin e zvogëlimin të rrezikut gjithëpërfshirës të fatkeqësive në Evropë. Prandaj, ky Udhërrëfyes adreson aftësinë e kufizuar në disa fusha, d.m.th. *mirëkuptimin dhe komunikimin e rrezikut* (udhërrëfyese njih rrezikun joproporcional me të cilin përballen personat me aftësi të kufizuara dhe thekson nevojën për investime në mjete gjithëpërfshirëse dhe të arritshme për të komunikuar këtë rrezik, duke përfshirë ndarjen e të dhënave sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar), *qeverisjen dhe vendimmarrjen e rrezikut* (njohuritë, aftësitë, burimet dhe përvojat e atyre më të rrezikuarve përfshihen si thelbësore në mbështetjen e zvogëlimin gjithëpërfshirës të rrezikut nga fatkeqësitë), *investimet gjithëpërfshirëse dhe inovative* (duke mos lënë askënd pas), *gatishmërinë për përgjigje dhe rimëkëmbjen rezistente* (sistemet e paralajmërimit të hershëm duhet të jenë të arritshme, gatishmëria për emergjenca komplekse duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe zhvillimi i mjeteve të reja duhet të ketë përparësi në qasje).³²

³⁰ <https://efdr.undrr.org/>

³¹ <https://www.undrr.org/publication/european-forum-disaster-risk-reduction-roadmap-2021-2030>

³² <https://www.edf-feph.org/edf-welcomes-regional-roadmap-to-resilience/>



2.5. Habitat III – Agjenda e re urbane³³

“Në përcaktimin e vizionit të saj për komunitete të jetueshme, të arritshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, Agjenda e re urbane përfshin referenca të shumta për ndërthurjen e popullatave, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Përveç promovimit të qasjes së barabartë dhe të përbalueshme në infrastrukturën e qëndrueshme fizike dhe sociale, Agjenda e re urbane gjithashtu përmend nevojën për të fuqizuar dhe siguruar kontributet e të gjithë aktorëve përkatës, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.”³⁴



2.6. Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara³⁵

Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara u miratua nga Shtetet anëtare të OKB-së në vitin 2006 dhe hyri në fuqi në vitin 2008 dhe në përputhje me rrethanat, si një mekanizëm ligjor i detyrueshëm, u ratifikua nga 185 prej 193 shtete anëtare të OKB-së. Është traktati i parë ndërkombëtar për të drejtat e njeriut që trajton dhe rregullon të drejtat civile dhe politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në kontekstin e aftësisë së kufizuar. Qëllimi i saj është *“të promovojë, mbrojë dhe sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm”* (Neni 1). Zyra e Komisionerit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut i referohet Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara si një plan veprimi për të përfshirë dhe mbështetur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.³⁶ Preambulla e Konventës pohon se *“respektimi i instrumenteve të zbatueshme të të drejtave të njeriut janë të domosdoshme për mbrojtjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht gjatë konflikteve të armatosura dhe pushtimit të huaj, duke përfshirë dhe emergjencat”*³⁷. Prandaj, aspektet e rëndësishme të Konventës janë që shtetet janë bartësit kryesorë të detyrës për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre janë të pajisur me një rol qëndror dhe zë në të gjitha aspektet e zbatimit të saj³⁸ dhe përqafojnë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut për aftësinë e kufizuar në mbrojtjen humanitare të personave me aftësi të

³³ <https://habitat3.org/wp-content/uploads/NUA-English.pdf>

³⁴ Instrumenti global për zvogëlimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë Përfshirja e aftësisë së kufizuar në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë Praktikë dhe mundësitë premtuese për angazhimin e zgjeruar. GFDRR. 2017. f. 28. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3mwta9z6>

³⁵ <https://tinyurl.com/2p8pr4py>

³⁶ https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/Disabilities_training_17EN.pdf

³⁷ <https://tinyurl.com/4yxx2nbn>

³⁸ UNDRR. Personat me aftësi të kufizuara në situata rreziku: Një studim mbi nenin 11 të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Zyra e Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (UNDRRR) 2022. f. 11. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/4c66ua4p>

kufizuara duke kërkuar që të gjithë aktorët të hedhin poshtë referencat për personat me aftësi të kufizuara si një grup “i rrezikuar” ose “i neglizhuar” në lidhje me emergjencat³⁹. Nenet e mëposhtme nga Konventa kanë rëndësi përkatëse në situatat e rrezikut dhe emergjencat humanitare dhe mbështesin përpjekjet gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë:

- *Neni 11* i Konventës është dispozita qendrore që i referohet detyrimeve në situata rreziku, duke përfshirë “emergjencat humanitare dhe fatkeqësitë natyrore. Ajo u bën thirrje palëve në Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara “*të marrin, duke ndjekur detyrimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata rreziku, duke përfshirë situatat e konfliktit të armatosur, emergjencat humanitare dhe ndodhjen e fatkeqësive natyrore.*”
- *Neni 3* përcakton parimet themelore të Konventës, përkatësisht pjesëmarrjen, llogaridhënien, mosdiskriminimin dhe fuqizimin⁴⁰, duke bërë zgjedhjet e tyre; dhe duke u njohur dhe respektuar si qytetarë të barabartë dhe qenie njerëzore me një kontribut për të dhënë para, gjatë dhe pas një emergjence, e cila duhet të respektohet gjatë këtyre situatave.
- Sipas *Neni 4*, personat me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes. Kjo kërkon që shtetet të sigurojnë pjesëmarrje aktive dhe kuptimplote të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara, d.m.th. pjesëmarrje aktive dhe koordinim në krijimin e politikave dhe rregulloreve dhe zbatimin e masave dhe veprimeve në lidhje me emergjencat dhe fatkeqësitë natyrore gjatë të gjitha fazave të ciklit të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë.
- *Neni 6*, në përputhje me nenin 11, adreson se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara⁴¹ i nënshtrohen diskriminimit të shumëfishtë dhe ndërsektorial dhe janë në rrezik të shtuar të dhunës seksuale, duke përfshirë krizat humanitare dhe konfliktet dhe mjediset pas konfliktit. Aty Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përcakton se shërbimet e përshtatshme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në situata rreziku dhe emergjence humanitare, bazuar në nevojat e tyre individuale, duhet të vihen në dispozicion dhe qasja e tyre duhet të sigurohet duke hequr pengesat fizike, komunikuese, sociale, kulturore, ekonomike, politike dhe të tjera, duke përfshirë zgjerimin e shërbimeve cilësore në zonat rurale dhe të largëta.⁴²
- *Neni 8* promovon rritjen e ndërgjegjësimit për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe, lidhur me Nenin 11, u bën thirrje Shteteve të angazhohen në masa ndërgjegjësimi në të gjithë shoqërinë për të luftuar stereotipet, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme në lidhje me personat me aftësi të kufizuara dhe për të promovuar ndërgjegjësimin për aftësitë dhe kontributet e tyre.

³⁹ Studimi tematik mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara sipas nenit 11 të KDPAK mbi situatat e rrezikut dhe emergjencat humanitare OHCHR, A/HRC/31/30 f.3 Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/mm4t9run>

⁴⁰ Rezoluta e KDNJ-së. Ibid. Paragrafi paprak 14, si dhe Parag 5, d dhe 6.

⁴¹ KDPAK *Komenti i përgjithshëm i Komitetit nr.3 për nenin 6 për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara*. KDPAK/C/GC/3, shtator 2016. Para. 50. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3jab9bu>

⁴² KDPAK *Deklaratë e Komitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mbi përfshirjen e aftësisë së kufizuar për Samitin botëror humanitar*. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3nshtrws>

- **Neni 9** i referohet qasjes së personave me aftësi të kufizuara në një spektër të gjerë shërbimesh, duke filluar nga mjedisi i ndërtuar deri te shërbimet e urgjencës, d.m.th. mjedisi fizik, transporti, informacioni dhe komunikimi dhe shërbimet publike. Në situata rreziku, fatkeqësitë natyrore dhe konfliktet e armatosura, shërbimet e emergjencës duhet të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara ose jetët e tyre nuk mund të shpëtohen ose mirëqenia e tyre të mbrohet. Qasshmëria duhet të përfshihet si prioritet në përpjekjet e rindërtimit pas katastrofës. Prandaj, zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë duhet të jetë i arritshëm dhe gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar.⁴³ Detyrat e shteteve për qasjen, sipas nenit 9, janë të domosdoshme për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të mos përjashtohen gjatë situatave të rrezikut dhe emergjencës humanitare, veçanërisht në lidhje me mekanizmat e informacionit dhe alarmit. Ato janë gjithashtu vendimtare në mbështetjen dhe promovimin e dizajnit universal (neni 2 i Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara), veçanërisht gjatë rindërtimit.
- **Neni 12** përcakton të drejtën për njohje të barabartë para ligjit, mbështet ushtrimin e kapaciteteve ligjore nga të rriturit me aftësi të kufizuara dhe kërkon zbatimin e vendimmarrjes së mbështetur, duke u larguar nga skemat e zëvendësuara të vendimmarrjes. Kjo e drejtë është veçanërisht e rëndësishme në raste emergjencash, d.m.th. kur personave me aftësi të kufizuara u kërkohet të marrin vendime kyçe në lidhje me pronën e tyre, rregullimet e jetesës, financat dhe trajtimet mjekësore dhe nuk mund t'i nënshtrohen derogimit.
- **Neni 21**, në përputhje me nenin 11, u bën thirrje shteteve të sigurojnë që të gjitha informacionet e lidhura me emergjencat të vihen në dispozicion në formate të qasshme për personat me lloje të ndryshme të lëndimeve, duke përfshirë personat e shurdhër përmes gjuhës së shenjave dhe në gjuhët e ndryshme që fliten në territorin e tyre. Gjithashtu, shtetet duhet të inkurajojnë mediat që të marrin një rol aktiv dhe gjithëpërfshirës, në të gjitha nivelet - lokale, kombëtare, rajonale dhe globale - si dhe të miratojnë politika specifike të komunikimit për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si dhe të mbështesin sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe masat mbrojtëse për shpëtimin e jetës, si dhe të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të publikut dhe të përhapin informacione të sakta dhe jo të ndjeshme për rrezikun nga fatkeqësitë, rreziqet dhe fatkeqësitë, duke përfshirë edhe për fatkeqësitë në shkallë të vogël, në një mënyrë të thjeshtë, transparente, të lehtë për t'u kuptuar dhe të arritshme.
- **Neni 31** i referohet nevojës për të mbledhur informacione dhe të dhëna statistikore dhe hulumtuese për formulimin e politikave përkatëse gjithëpërfshirëse, ndërsa sigurohet ndarja e të dhënave, qasja dhe privatësia. Mbledhja dhe analiza e të dhënave të ndara, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, është një element kritik në hartimin e politikave gjithëpërfshirëse, edhe në situata të konfliktit të armatosur, emergjencave humanitare dhe fatkeqësive natyrore. Përveç kësaj, Shtetet palë duhet të sigurojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha të dhënat statistikore në formate të qasshme.
- **Neni 32** promovon bashkëpunimin ndërkombëtar, duke përfshirë programet ndërkombëtare të zhvillimit që janë gjithëpërfshirëse dhe të arritshme për personat me aftësi të kufizuara, dhe mund të shihet përmes Nenit 11 dhe Synimit F të Kornizës Sendai për

⁴³ CRPD. Committee's General Comment no. 2 on Article 9, CRPD/C/GC/2, Para. 36. <https://tinyurl.com/mrxckn58>

rritjen thelbësore të bashkëpunimit ndërkombëtar me shtetet në zhvillim deri në vitin 2030. Duke marrë parasysh të parën, personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesë e këtij procesi të bashkëpunimit në të gjitha fazat dhe duhet të promovohen dhe forcohen në të gjitha nivelet, duke përfshirë në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, dhe qasjen në dhe ndarjen e teknologjisë së qasshme dhe ndihmëse.

- *Neni 33* nxit që shtetet palë duhet të lejojnë vazhdimin e monitorimit gjatë emergjencave, duke siguruar që rreziqet të zbuten në masën maksimale të mundshme. Kur monitorimi personal është i pamundur, shtetet palë duhet t'i kushtojnë burime të disponueshme miratimit të alternativave, të tilla si digjitale, elektronike ose mënyra të tjera të komunikimit në distancë, për të siguruar monitorim efektiv të pavarur.⁴⁴

Veçanërisht, miratimi i Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara krijoi një mandat për Kombet e Bashkuara dhe shkaktoi miratimin e një *Strategjie të përfshirjes së aftësisë së kufizuar* në mbarë OKB-në që angazhohet për një model të bazuar në të drejtat e përfshirjes së aftësisë së kufizuar. Komiteti i Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara – një organ monitorues ndërkombëtar që shqyrton zbatimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara – ka lëshuar disa deklarata të përgjithshme duke marrë parasysh nenin 11, konkretisht:

- Deklaratë mbi “situatën e personave me aftësi të kufizuara të prekura nga fatkeqësitë në Peru, Ekuador dhe Kolumbi” (Miratuar në sesionin e 17-të të CRPD - 20 mars deri më 12 prill 2017)⁴⁵;
- Deklaratë e përbashkët e CMW-CRPD mbi “Adresimin e aftësive të kufizuara në lëvizjet në shkallë të gjerë të refugjatëve dhe emigrantëve”, (Prill 2017)⁴⁶;
- Deklaratë nga Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara - PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË URBANE - Sigurimi i gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Agjendën e re urbane-Habitat III – Konferenca e tretë e Kombeve të Bashkuara për banimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, (nëntor 2016)⁴⁷;
- Deklaratë e Komitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për përfshirjen në Samitin botëror humanitar (e miratuar në sesionin e 14-të të CRPD - 17 gusht deri më 4 shtator 2015)⁴⁸;
- Deklaratë mbi përfshirjen e aftësisë së kufizuar në konferencën e tretë botërore mbi zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe më tej (Shtator 2014)⁴⁹;
- Deklaratë për përfshirjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në agjendën post-2015 për aftësi të kufizuara dhe zhvillim (Janar 2014)⁵⁰.

⁴⁴ KDKPAK Udhëzime për deinstitutionalizimin, duke përfshirë edhe rastet emergjente. (2022). <https://tinyurl.com/4dbxaex2>

⁴⁵ <https://tinyurl.com/k72tx33k>

⁴⁶ <https://tinyurl.com/yckwuu93>

⁴⁷ <https://tinyurl.com/5n6wcjxk>

⁴⁸ <https://tinyurl.com/4fz3av5k>

⁴⁹ <https://tinyurl.com/bde896ka>

⁵⁰ <https://tinyurl.com/3j2cvav4>



2.7. Rezoluta e Këshillit të OKB-së për të drejtat e njeriut⁵¹

Dy zhvillime të rëndësishme kontribuan në ndërtimin e rezistencës të personave me aftësi të kufizuara gjatë emergjencave, konflikteve të armatosura dhe fatkeqësive natyrore. *Raporti tematik i OHCHR-së nga viti 2015*⁵² spërcakton standardet për të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara në situata të rrezikut dhe emergjencave humanitare dhe paraqet një kuptim të harmonizuar të së drejtës ekzistuese humanitare ndërkombëtare sipas nenit 11 të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. “*Raporti gjithashtu vuri në dukje dështimin e qeverive dhe të tjerëve për të ndërmarrë veprime të arsyeshme parandaluese për të zvogëluar rrezikueshmërinë dhe për të rritur rezistencën e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për të siguruar zbatje efektive.*”⁵³ Në vitin 2016, Këshilli i të drejtave të njeriut miratoi *Rezolutën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në situatat e rrezikut dhe emergjencave humanitare*⁵⁴ e cila u bën thirrje shteteve të “*marrin masa efektive për të siguruar mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e situatave të konfliktit të armatosur, emergjencave humanitare dhe ndodhjes së fatkeqësive natyrore*”. Ai theksoi nevojën për të përforcuar zbatimin e nenit 11, duke përfshirë përforcimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesve të tyre në të gjitha fazat e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë.⁵⁵ Në maj të vitit 2020, Zyra e komisionerit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut dha udhëzime për COVID-19 dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara⁵⁶.

⁵¹ <https://www.ohchr.org/en/hr-bodies/hrc/about-council>

⁵² <https://tinyurl.com/5fb39d2u>

⁵³ UNDRR. *Personat me aftësi të kufizuara në situata rreziku: Një studim mbi nenin 11 të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*. Zyra e Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (UNDRRR) 2022. f. 20. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/4c66ua4p>

⁵⁴ <https://tinyurl.com/3ec8datk>

⁵⁵ UNDRR. *Personat me aftësi të kufizuara në situata rreziku: Një studim mbi nenin 11 të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*. Zyra e Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (UNDRRR) 2022. f. 20. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/4c66ua4p>

⁵⁶ <https://tinyurl.com/5n3nn3h9>

2.8. Harmonizimi i Maqedonisë së Veriut me kornizën globale të qëndrueshme dhe rezistente

Figure 2. Marrëveshjet relevante të politikave globale dhe anëtarësimet e Maqedonisë së Veriut (Autori)



- **Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Protokolli opsional** - Maqedonia e Veriut është një nga 175 palët e Konventës dhe përfshirja e aftësisë së kufizuar shkoi më lart në agjendën e zhvillimit dhe mund të theksohet përparimi në gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Konventa u nënshkrua më 30 mars të vitit 2007, Protokolli opsional u nënshkrua më 29 korrik 2009 dhe të dy dokumentet u ratifikuan më 5 dhjetor 2011. Meqenëse është ratifikuar në përputhje me Kushtetutën, është pjesë e sistemit ligjor kombëtar, d.m.th. dispozitat e përfshira në Konventë janë drejtpërdrejt të zbatueshme. “Në periudhën në vijim, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara u avancuan për shkak të reformave të vazhdueshme në mbrojtjen sociale dhe arsimin, dhe zhvillimeve në fushat e mosdiskriminimit, shërbimeve gjithëpërfshirëse të punësimit, deinstitucionalizimit, qasjes në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe promovimit të barazisë gjinore. Vullneti politik për të siguruar pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara është i dukshëm dhe reflektohet në kuadrin legjislativ.”⁵⁷ Megjithatë, shumë aspekte janë ende të hapura dhe nuk mund të vihet re përparim në lidhje me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.
- **Korniza Sendai** – Maqedonia e Veriut ishte një nga 187 vendet që miratuan Kornizën Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015 – 2030 gjatë Konferencës së tretë botërore të OKB-së për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë të mbajtur në mars të vitit 2015 në Sendai, Japoni. Ajo është nxitësi kryesor për zhvillimin e menaxhimit kombëtar të rrezikut nga fatkeqësitë. Megjithatë, vendi nuk ka paraqitur zyrtarisht raporte mbi përparimin në arritjen e synimeve.⁵⁸ Gjithashtu, “vendit i mungon një strategji kombëtare e rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me Kornizën Sendai dhe ka sfida të rëndësishme në

⁵⁷ OKB. Analiza e situatës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2021. P.8. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2kr2xzpc>

⁵⁸ <https://sendaimonitor.undrr.org/>

*përputhje me legjislacionin dhe standardet e Bashkimit Evropian.*⁵⁹ Duke marrë parasysh objektivat e Kornizës Sendai, nuk ka asnjë raport zyrtar të paraqitur dhe nuk ka të dhëna nga Monitoruesi i kornizës Sendai.

- **Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm** – Raporti i zhvillimit të qëndrueshëm⁶⁰ vlerëson progresin e vendit drejt arritjes së Qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm bazuar në treguesit e QZHQ dhe rishikimin kombëtar vullnetar. Në rrugën e duhur ose mirëmbajtjen e Qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm janë këto Qëllime: 1, 6, 8, 10 dhe 12, ndërsa përmirësimi i moderuar me sfida të rëndësishme të mbetura janë Qëllimet 2, 3, 5, 15, 16 dhe 17. Rezultatet që stagnojnë ose rriten në më pak se 50% të normës së kërkuar identifikohen në fushën e Qëllimeve 4, 7, 9 dhe 11, por Qëllimi 13 për veprimin klimatik është me një rezultat të ulur.
- **Marrëveshja e Parisit** – Lidhur me Marrëveshjen e Parisit (2015), vendi ka paraqitur Kontributet e synuara të përcaktuara në nivel kombëtar për ndryshimin e klimës, si dhe kontributin e zgjeruar të përcaktuar në nivel kombëtar⁶¹. Lidhur me *mekanizmin ndërkombëtar të Varshavës për humbje dhe dëme*⁶², deri më tani vendi nuk është angazhuar sa duhet në raportimin e humbjeve dhe dëmeve dhe në shfrytëzimin e përfitimeve nga mekanizmi, por “planifikon të zhvillojë një Plan Kombëtar të përshtatjes bazuar në qasjet e lidhjes në fushat e mëposhtme: uji, ushqimi, energjia, shëndeti, biodiversiteti, turizmi, pylltaria, zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë, humbja dhe dëmtimi, infrastruktura e integruar.”⁶³ Planet kombëtare të përshtatjes mund të sigurojnë integrimin koherent të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.
- **Agjenda e re urbane** – Dukshmëria e zbatimit të kësaj kornize globale është e pamjaftueshme.

⁵⁹ UNDP. Dokumenti i programit të vendit për Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2025) .f.4. <https://tinyurl.com/2p9xnt2b>

⁶⁰ <https://dashboards.sdgindex.org/profiles/north-macedonia>

⁶¹ <https://tinyurl.com/3fbsfcre>

⁶² <https://tinyurl.com/yc7m45ks>

⁶³ <https://tinyurl.com/2vktzybt> p.20

3. KONTEKSTI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NË MAQEDONINË E VERIUT NË LIDHJE ME PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

3.1. Kuadri politik dhe rregullator i sistemeve kombëtare të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirjes së aftësive të kufizuara

Korniza ekzistuese e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë në vend, në kontekstin e gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, përbëhet nga një kornizë legjislative dhe infrastruktura institucionale përkatëse. Në këtë kontekst, kjo pjesë e dokumentit është një rishikim i sistemeve të menaxhimit, mbrojtjes dhe shpëtimit të krizave, duke përfshirë kornizën thelbësore normative nga fusha e shëndetit publik në lidhje me pandeminë vijuese të KOVID-19 dhe kornizën kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe përforcimin e rezistencës urbane dhe rëndësinë në rritje të ekzistencës dhe mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara, rishikimi përfshin një pasqyrë të shkurtër të politikës thelbësore dhe kornizës rregullatore në fushat e ndryshimit të klimës, planifikimit hapësinor/urban dhe përfshirjes së aftësisë së kufizuar. Lidhur me hierarkinë vertikale të akteve ligjore që rregullojnë zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, struktura është si më poshtë:

- Në *Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018)*⁶⁴ tnuak ka asnjë dispozitë të drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, por neni 125 përcakton se Kuvendi mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme përmes procedurës së rregullt në rast të një fatkeqësie natyrore ose epidemie. Duke pasur parasysh personat me aftësi të kufizuara, Kushtetuta parashikon mbrojtjen e tyre në bazë të nenit 35, paragrafi 2 dhe 3 - “Republika u garanton atyre të drejtën e ndihmës për të sëmuret dhe për qytetarët e paaftë për punë. Republika siguron mbrojtje të veçantë të personave me aftësi të kufizuara dhe kushte për përfshirjen e tyre në jetën sociale”.
- Nga aspekti i rregullave ligjore, u analizuan ligjet për mbrojtjen dhe shpëtimin, menaxhimin e krizave, zjarrrfikësit, kujdesin shëndetësor, shëndetin publik dhe mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet infektive. *Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (2004)*⁶⁵ nuk përfshin aspekte të aftësisë së kufizuar, as në aspektin e nevojave dhe as aftësive të personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, Ligji parashikon disa formulime të përgjithshme, p.sh. në operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit i jepet përparësi jetës dhe shëndetit të njerëzve (neni 6, paragrafi 1, pika 2), të gjithë janë përgjegjës për të mbështetur operacionet e mbrojtjes dhe

⁶⁴ <https://tinyurl.com/4hkfuxze>

⁶⁵ Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 36/04, 49/04, 86/08, 124/10, 18/11, 41/14, 129/15, 71/16, 106/16, 83/18, 215/21)

shpëtimit brenda mundësive të tyre (neni 6, paragrafi 1, pika 3); kategoritë e mëposhtme të qytetarëve përjashtohen nga detyra për të marrë pjesë në forcat e mbrojtjes dhe shpëtimit: gratë shtatzëna, nënat dhe prindërit dhe kujdestarët e vetëm që kanë ose po kujdesen për një fëmijë (neni 42), por personat me aftësi të kufizuara nuk janë njohur ose përfshirë. Për më tepër, nuk ka konsiderata specifike për aftësinë e kufizuar në grupin e masave të mbrojtjes dhe shpëtimit, d.m.th. evakuimi, strehimi, mbrojtja nga përmytjet dhe zjarri ose në aktivitetet e edukimit dhe vetëdijësimit. *Ligji për menaxhimin me krizat (2005)*⁶⁶ dhe *Ligji për zjarrfikje (2017)*⁶⁷ nuk përfshijnë dispozita në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe/ose nevojat dhe aftësitë e personave me aftësi të kufizuara. Edhe në fushën e shëndetësisë situata është e ngjashme. *Ligji për mbrojtjen shëndetësore (2016)*⁶⁸ nuk përfshin aspektet e aftësisë së kufizuar dhe vetëm parimi i drejtësisë midis grupeve të tjera të popullsisë u referohet personave me aftësi të kufizuara mendore ose fizike. Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet shëndetësore janë të detyruara në aktet e përgjithshme, sipas ligjit, të përcaktojnë detyrat e tyre për sigurimin e kujdesit shëndetësor në kushte emergjente dhe kriza (fatkeqësi natyrore dhe aksidente të tjera të rënda dhe emergjenca), të sigurojnë mjete për të grumbulluar burime, për të përshtatur punën e tyre dhe për të bashkëpunuar me Qendrën për menaxhim me kriza, Drejtorinë e mbrojtjes dhe shpëtimit dhe aktorë të tjerë (Nenet 281 – 284). *Ligji për shëndetin publik (2016)*⁶⁹ dhe *Ligji për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet infektive (2016)*⁷⁰ gjithashtu nuk përfshijnë aspektet e aftësisë së kufizuar, por i pari formulon në mënyrë unike që instituti i shëndetit publik dhe qendrat e shëndetit publik të kryejnë ndërhyrje që nuk diskriminojnë individët në bazë të racës, gjinisë ose prejardhjes së ndryshme kombëtare dhe sociale, ose statusit të pronës, besimit fetar, gjinisë, orientimit seksual ose statusit të një personi me nevoja të veçanta (neni 16).

- Në aktet *nënligjore që rregullojnë mbrojtjen dhe shpëtimin*⁷¹, nuk janë përfshirë dispozita në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe/ose nevojat dhe aftësitë e personave me aftësi të kufizuara. Vetëm neni 5 i *Rregullores për zbatimin e masave të mbrojtjes dhe shpëtimit për evakuimin e popullsisë (2010)*⁷² përcakton kategoritë e popullsisë që janë subjekt i evakuimit: fëmijët deri në 7 vjeç, gratë shtatzëna ose nënat e fëmijëve deri në 7 vjeç, fëmijët deri në 14 vjeç, prindërit ose kujdestarët e të cilëve janë mobilizuar në forcat e mbrojtjes dhe të shpëtimit dhe personat me aftësi të kufizuara ose të palëvizshëm.
- Konteksti i *akteve nënligjore që rregullojnë menaxhimin e krizave* është i ndryshëm sepse aspekte të caktuara përfshihen në dokumente të ndryshme. *Rregullorja për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë për Republikën e Maqedonisë nga të gjitha rreziqet, përmbajtja dhe struktura e saj, mënyra e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimi i subjekteve në sistemin e menaxhimit të krizave, të cilave u dorëzohet një deklaratë e plotë ose nga vlerësimi (2011)*⁷³ në pjesën e përgjithshme të vlerësimit,

⁶⁶ Ligji për menaxhimin me krizat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 29/2005, 36/2011, 41/2014, 104/2015 and 215/21).

⁶⁷ Ligji për zjarrfikës – Teksti i spastruar (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 168/17).

⁶⁸ Ligji për mbrojtjen shëndetësore – Teksti i spastruar i redaktuar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/16).

⁶⁹ Ligji për shëndetin publik – Teksti i spastruar i redaktuar (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/16).

⁷⁰ Ligji për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/04, 139/08, 99/09, 149/14, 150/15 dhe 37/16).

⁷¹ <https://www.dzs.gov.mk/direkcija/2>

⁷² Rregullore për zbatimin e masës për mbrojtje dhe shpëtim - evakuim të popullatës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 101/10)

⁷³ Rregullore për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë për Republikën e Maqedonisë nga të gjitha rreziqet dhe rreziqet,

III. Elementet e rrezikut, 3.3 Profili demografik i referohet numrit dhe karakteristikave të vendbanimeve, numrit dhe strukturës së popullsisë duke përfshirë numrin e personave me nevoja të veçanta, si dhe ndryshimet nga 2 – 3 vitet e fundit. Për më tepër, në pjesën specifike të Vlerësimit, II. Vlerësimi i rrezikut – Procedurat dhe aktivitetet, (2) Vlerësimi i rrezikueshmërisë dhe ekspozimi i elementeve specifike ndaj të cilave drejtohet rreziku, pjesët përkatëse janë si më poshtë: 2.3. Analiza cilësore dhe sasiore e popullsisë së ekspozuar (struktura gjinore, grupmoshat, grupet me nevoja të veçanta, etj.), me hartëzim dhe 2.5 Vlerësimi i ndikimit (rrezikueshmëria dhe ekspozimi) i rrezikut konkret për popullatën. Si rezultat, në vlerësimet e rrezikut të komunave, Qyteti i Shkupit dhe Shteti, sipas nenit të lartpërmendur 3.3 Profili demografik, numri dhe profilet, si dhe organizatat dhe shoqatat e shoqërisë civile në territorin e komunës ose Qytetit të Shkupit. Për çdo rrezik të pranishëm natyror dhe të bërë nga njeriu në territorin e komunës ose Qytetit të Shkupit, përfshihet numri dhe profili i popullatës së ekspozuar dhe të rrezikuar, p.sh. me aftësi të kufizuara fizike, dëmtime të shikimit dhe dëgjimit. Në *procedurat standarde të operimit për komunikim, koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet subjekteve të Sistemit të menaxhimit me krizat gjatë një krize të deklaruar. (2016)*⁷⁴ në pjesën 4.1. Funksionet që mundësojnë reagimin dhe mbështetjen gjatë një tërmeti, Ndhimja për personat e prekur, drejtpërdrejtë dhe kujdesi dhe transporti i personave me aftësi të kufizuara bëhen nga Ministria e punës dhe politikës sociale dhe Ministria e shëndetësisë për 2 orë. Në pjesën 7.1. Funksionet që mundësojnë reagimin dhe mbështetjen gjatë temperaturave jashtëzakonisht të larta ose të ulëta dhe mjegullës së dendur, ndihma për personat e prekur drejtpërdrejtë, akomodimi dhe ndihma për personat me aftësi të kufizuara sigurohet nga Ministria e punës dhe politikës sociale dhe Ministria e shëndetësisë për 24 orë.

- Brenda kontekstit më të gjerë të menaxhimit të rrezikut dhe zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, u shqyrtua korniza ekzistuese kombëtare e ndryshimit të klimës. *Strategjia afatgjate për veprimin klimatik (2022)*⁷⁵ synon të zvogëlojë emetimet kombëtare neto të gazrave serrë me 72% deri në vitin 2050 krahasuar me nivelet e vitit 1990 dhe të rrisë rezistencën e shoqërisë, ekonomisë dhe ekosistemeve ndaj ndikimeve të ndryshimit të klimës. Për monitorimin e rrezikueshmërisë socio-ekonomike ndaj ndryshimeve klimatike, treguesit e statusit social dhe ekonomik mund të përfshijnë strukturën demografike (p.sh. përqindja e popullsisë më pak të privilegjuar ose të varur si gratë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara). Si pjesë e masave për integrimin e zgjeruar të klimës në arsim, hulumtim dhe zhvillim, inovacion dhe vetëdijësim për të mbështetur zhvillimin e një kornize ligjore dhe fonde për të mbrojtur grupet e rrezikuara klimatike, duke përfshirë gratë, fëmijët, të moshuarit dhe njerëzit me aftësi të kufizuara. *Projektligji për veprimin klimatik (2020)*⁷⁶ dhe *Projektligji për veprimin klimatik (2020)*⁷⁷ nuk përfshijnë aspektet e aftësisë së kufizuar, as në aspektin e nevojave dhe as aftësive të personave me aftësi të kufizuara. Në kontekstin e rrezikueshmërisë, më shumë vëmendje i kushtohet aspekteve të gjinisë dhe ndryshimit të klimës. Për shembull, në *Komunikimin e katërt*

përmbajtjen dhe strukturën e saj, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin e menaxhimit të krizave të cilave u është dorëzuar një deklaratë e plotë ose nga vlerësimi (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.13/11)

⁷⁴ <https://eprints.ugd.edu.mk/21882/>

⁷⁵ <https://tinyurl.com/ytbw4w9y>

⁷⁶ <https://tinyurl.com/54etuusr>

⁷⁷ <https://tinyurl.com/3faakwca>

*kombëtar për ndryshimin klimatik (2022)*⁷⁸ ato janë përpunuar posaçërisht, *Kontributi i zgjeruar i përcaktuar kombëtar (2021)*⁷⁹ përfshin aspektet gjinore si tregues për politikat dhe masat për zbutjen dhe *Raporti i tretë bienal i përditësimit për ndryshimin klimatik (2020)*⁸⁰ përpunon integrimin gjinor në një pjesë të veçantë.

- Segmenti i planifikimit hapësinor dhe urban është përqendruar kryesisht në sigurimin e qasjes në ndërtesa dhe objekte për personat me aftësi të kufizuara dhe qasja rishikohet në këtë dokument në kontekstin e zvogëlimit të rrezikut. Për shembull, *Ligji për planifikimin urban (2020)*⁸¹ përfshin tejkalimin e barrierave urbane për personat me aftësi të kufizuara ndër prioritetet e planifikimit urban. Normat përkatëse për sigurimin e lëvizjes së qetë dhe qasjes së personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe fëmijëve janë pjesë e aktit nënligjor. *Rregullorja për planifikimin urban (2020)*⁸² përcakton personat me aftësi të kufizuara si persona me aftësi të kufizuara të përhershme ose të përkohshme fizike, mendore dhe/ose shqisore, ku pengesat urbane dhe arkitekturore zvogëlojnë ose parandalojnë lëvizshmërinë e tyre, qasjen në ndërtesa dhe zona, dhe kështu pjesëmarrjen e tyre në shoqëri mbi baza të barabarta dhe ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut. Sigurimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara është pjesë e pjesës tekstuale të dizajnit urban. Detajet teknike për lëvizjen dhe qasjen e personave me aftësi të kufizuara përcaktohen dhe planet urbane duhet të kontribuojnë në rritjen e barazisë dhe drejtësisë në qasjen dhe gëzimin e hapësirave të gjelbra urbane për të gjitha grupet e njerëzve, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar, si dhe grupet e tjera të rrezikuara të banorëve. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i planeve urbane duhet të sigurojë tejkalimin e pengesave urbane dhe sigurimin e qasjes dhe lëvizshmërisë funksionale të tokës për përdorim të përgjithshëm, hapësira publike, pranë dhe në ndërtesa dhe zona brenda dhe jashtë vendbanimeve për të gjithë qytetarët, dhe veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar.
- Në kuadër të këtij studimi është analizuar edhe fusha e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara për të kuptuar gjendjen e përfshirjes së zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë. Nga perspektiva e dokumenteve strategjike që i referohen përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, gjatë periudhës së shqyrtimit, *Strategjia kombëtare e rishikuar për kualifikimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara 2010-2018*⁸³ është ndërprerë, *ndërsa është në shqyrtim dhe nuk është miratuar draft versioni i dokumentit të ri strategjik – Strategjia kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2023 – 2030 me Planet e veprimit 2023 -2026*⁸⁴ po merret në konsideratë dhe nuk është miratuar.⁸⁵ Për të kuptuar më mirë planifikimin strategjik të përfshirjes së aftësisë së kufizuar dhe ekzistencën e integritimit me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, u shqyrtuan të dy dokumentet.

Në tekstin e *strategjisë së parë*, zvogëlimi i rreziqeve nga fatkeqësitë nuk u përfshi dhe fokusi

⁷⁸ <https://tinyurl.com/54xm6dxdp>

⁷⁹ <https://tinyurl.com/38tbzt9f>

⁸⁰ <https://tinyurl.com/2654yamw>

⁸¹ Ligji për planifikim urban (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.32/20)

⁸² Rregullorja për planifikim urban (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.32/20)

⁸³ <https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/FINALNA%20Revidirana%20Nacionalna%20Strategjia.pdf>

⁸⁴ <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detailid=61>

⁸⁵ Teksti i Draft versionit të Strategjisë kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2023-2030 me Planet e veprimit 2023-2026 u botua më 3 prill 2023 në ENER dhe në kohën e përgatitjes së këtij studimi ishte ende në dispozicion për komente.

ishte në përmirësimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara si qytetarë të barabartë që gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë. Grupi i parimeve themelore të vendosura gjithashtu i referohet zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë duke krijuar politika ose duke ndërmarrë masa dhe aktivitete gjatë ndonjë prej fazave të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, të tilla si pavarësia, mosdiskriminimi, respektimi i dallimeve dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe njerëzimit në jetën e përbashkët; mundësi të barabarta; qasshmëria; barazia gjinore dhe koncepti i fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Strategjia e re kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara synon promovimin, mbrojtjen dhe gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë të barabartë me qytetarët e tjerë, si dhe promovimin e respektimit të dinjitetit të tyre. Fusha e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë përfshihet në disa fusha me rëndësi strategjike, megjithëse përdoret kryesisht nocioni situata krize. Në kuadër të *Fushës Prioritare 2: Barazia, qasja në drejtësi dhe pjesëmarrja aktive në jetën publike dhe politike, Qëllimi i veçantë 6 (Personat me aftësi të kufizuara ushtrojnë të drejtat e tyre në situata krize)* identifikon dy masa që duhet të sigurojnë mekanizma për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara në situata krize, duke përfshirë protokollet e dhura, informacionin e arritshëm, strehimet e arritshme, pajisjet e dhura dhe ndihmat e shpëtimit, etj., por edhe për të përforcuar kapacitetet e zyrtarëve të mbrojtjes dhe shpëtimit në nivel kombëtar dhe lokal për t'u marrë me personat me aftësi të kufizuara. Kështu, për shembull, parashikohet të sigurohen mekanizma për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara në situata të krizës (hartëzimi dhe përmirësimi i disponueshmërisë dhe qasshmërisë së strehimeve, sigurimi i informacionit dhe materialeve të arritshme në formate të arritshme për mbrojtje në situata të rrezikshme dhe analiza e ligjeve dhe praktikave të emergjencës dhe rreziqeve, për sigurimin e mbrojtjes dhe sigurisë së personave me aftësi të kufizuara) dhe përforcimi i kapaciteteve të oficerëve të mbrojtjes dhe shpëtimit në nivel kombëtar dhe lokal për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara (organizimi i trajnimit të rregullt vjetor për Qendrën për menaxhim me krizat dhe palëve të interesuara në sistemin e mbrojtjes për rreziqet në nivel kombëtar dhe lokal për sigurimin e mbrojtjes dhe sigurisë së personave me aftësi të kufizuara, zhvillimi i protokolleve për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara në kushtet e konflikteve ushtarake, zjarreve, emergjencave). Një tregues i performancës do të përmirësojë sistemin e mbrojtjes dhe shpëtimit me protokolle për mbrojtje dhe shpëtim gjithëpërfshirës. Gjithashtu, në kontekstin e të kuptuarit të rrezikut dhe vlerësimit të rreziqeve dhe planifikimit operacional, mbledhja dhe ndarja e të dhënave të përbashkëta janë jashtëzakonisht të rëndësishme, dhe gjithashtu në këtë kontekst të Qëllimit të veçantë 7: *Politikat në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara bazohen në të dhëna cilësore dhe sigurohen me një buxhet të përshatshëm*. Masat e parashikuara i referohen krijimit të një sistemi për regjistrimet dhe treguesit përkatës (të dhënat e zberthyer) për personat me aftësi të kufizuara dhe futjes së buxhetimit në bazë të aftësive të kufizuara (buxhetimi i bazuar në aftësi të kufizuara). Fusha të tjera që lidhen me analizën e lëndës janë qasja, konkretisht qasja në infrastrukturën fizike, qasja në sistemin e transportit dhe qasja digjitale (Fusha 1); qasja në kujdesin shëndetësor (Fusha 3); komunitetet lokale gjithëpërfshirëse (Fusha 7); dhe vetëdijësimi i publikut (Fusha 8).

- Në kuadër të kornizës legjislative u shqyrtuan dy akte ligjore, *Ligji për parandalimin*

dhe mbrojtjen nga diskriminimi⁸⁶ dhe Ligji për mbrojtjen sociale⁸⁷. Në të parën, neni 5 specifikon aftësinë e kufizuar si një nga arsyet e diskriminimit, duke përfshirë një përkufizim të personave me aftësi të kufizuara si “një person që ka një aftësi të kufizuar fizike, intelektuale, mendore ose shqisore afatgjatë, i cili ndërvepron me pengesa të ndryshme sociale që mund të parandalojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët” (neni 4). Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë nuk është i përfshirë në ligj, megjithëse diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar dhe kushteve shëndetësore, ndër të tjera, është i ndaluar (neni 5). Ligji i fundit jo vetëm që përcakton personat me aftësi të kufizuara si persona që kanë çrregullime afatgjata fizike, intelektuale, mendore ose shqisore, të cilat në bashkëveprim me pengesa të ndryshme mund të parandalojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët (neni 3), por gjithashtu rregullon mbrojtjen institucionale dhe jo-institucionale të personave me aftësi të kufizuara dhe sigurimin e ndihmës financiare. Ndihma e njëhershme financiare ose ndihma në natyrë i jepet një personi ose një familjeje që është në një gjendje të rrezikut shoqëror, si dhe një personi dhe familjes për shkak të një fatkeqësie ose epidemie ose trajtimit të zgjatur të një anëtari të familjes në një institucion shëndetësor.

3.2. Arkitektura institucionale e sistemeve kombëtare të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirjes së aftësisë së kufizuar

3.2.1. Korniza institucionale për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend

Sistemi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë në vend përbëhet nga menaxhimi i krizave dhe sistemet e mbrojtjes dhe shpëtimit. E para drejtohet nga Qendra për menaxhim të krizave dhe e dyta nga Drejtoria e mbrojtjes dhe shpëtimit. Për më tepër, sistemi kombëtar përfshin subjekte të tjera si ministrinë kryesore, institucionet kombëtare dhe lokale dhe ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, Kryqin e kuq të Maqedonisë së Veriut, shoqatat civile dhe organizatat joqeveritare, akademinë, sektorin privat, qytetarët dhe të tjerët.

- **Sistemi për menaxhim me krizat** – “Për të propozuar vendime dhe për konsultime të vazhdueshme, koordinim, reagim të shpejtë, përdorim efikas dhe të saktë të burimeve në dispozicion në situatat eventuale të krizës, ofrimin e një vlerësimi në kohë, cilësor dhe realist të rreziqeve për vendin, organet e mëposhtme janë themeluar brenda sistemit të menaxhimit të krizës: Këshilli drejtues, Grupi i vlerësimit dhe Qendra për menaxhim të krizave.”⁸⁸ Këshilli Drejtues është organi më i lartë dhe ka kompetencat për koordinimin dhe menaxhimin e sistemeve të menaxhimit të krizave, duke përfshirë situatat e krizës. Ai përbëhet nga përfaqësues të institucioneve kryesore në vend, p.sh. ministrinë e punëve të brendshme, shëndetësisë, transportit dhe lidhjeve, mbrojtjes, punëve të jashtme, kreu i Grupit të vlerësimit, përfaqësuesi i Komisionit parlamentar për mbrojtje dhe siguri dhe kabineti i Presidentit, si dhe përfaqësues të organeve të tjera shtetërore, ekspertëve të

⁸⁶ Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.258/20).

⁸⁷ Ligji për mbrojtjen sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 104/19).

⁸⁸ Popovski, Vasko. Studimi i politikave për menaxhimin e krizave. Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup. 2020. f. 15. Në dispozicion në: <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/04/1-ENG.pdf>

jashtëm dhe njësave të vetëqeverisjes lokale. *Grupi i vlerësimit* kryen vlerësime të vazhdueshme të rrezikut të sigurisë së vendit dhe propozon masa dhe veprime për zbutjen, paralajmërimin dhe reagimin e hershëm, duke këshilluar Këshillin drejtues për deklarimin e një situatë krize. Ai përbëhet nga drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e Qendrës për menaxhim me krizat dhe Drejtorisë së mbrojtjes dhe shpëtimit, Byrosë së sigurisë publike, Agjencisë për sigurinë nacionale, armatës, Shefit të departamentit për siguri dhe zbulim në Ministrinë e mbrojtjes, si dhe përfaqësues të organeve të tjera shtetërore, njësave të vetëqeverisjes lokale dhe ekspertëve të jashtëm. *Qendra për menaxhimin e krizave* është një institucion i pavarur shtetëror që kryen veprimtari për sigurimin e vazhdimësisë së bashkëpunimit ndërmjet departamentave dhe ndërkombëtar, konsultimin dhe koordinimin e menaxhimit të krizave, ofron mbështetje për dy organet e sipërpërmendura të sistemit të menaxhimit të krizave, propozon masa dhe aktivitete për zgjidhjen e krizave dhe realizon veprimtari të tjera në përputhje me ligjin. Në nivel rajonal dhe lokal, 8 qendra kryesore dhe 27 qendra rajonale për menaxhimin e krizave janë krijuar për të informuar, monitoruar dhe shkëmbyer informacione dhe të dhëna, për të bërë propozime për menaxhimin e krizave dhe për të përgatitur vlerësimet e rrezikut.

- **Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit** u krijua në vitin 2004 për mbrojtjen e popullsisë, mjedisit jetësor, të mirave materiale, burimeve natyrore, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore nga fatkeqësitë. *“Institucioni përkatës qendror në këtë drejtim është Drejtoria e mbrojtjes dhe shpëtimit me lokacion në Shkup dhe me 35 zyra satelitore në të gjithë vendin – shpërndarja e saj gjeografike është e barabartë me shpërndarjen e qendrave rajonale të menaxhimit të krizave.”*⁸⁹ Drejtoria e mbrojtjes dhe shpëtimit realizon një sërë aktivitete për mbrojtjen dhe shpëtimin duke përfshirë organizimin e SMSH, zhvillimin e vlerësimeve dhe planeve të mbrojtjes dhe shpëtimit, krijimin, edukimin dhe trajnimin e forcave të mbrojtjes dhe shpëtimit, etj. Në nivel lokal, komunat kanë përgjegjësi të caktuara që zbatohen nga këshillat komunale, kryetarët e komunave dhe administrata. Maqedonia e Veriut është anëtare e Mekanizmit të mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian.⁹⁰
- **Zyra e Koordinatorit kombëtar për zbatimin e Platformës kombëtare për reduktimin e rreziqeve nga aksidentet dhe fatkeqësitë.** Nuk ka një përshkrim të detajuar të kompetencave dhe përgjegjësi të koordinatorit kombëtar.
- **Platforma kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (2019)** - objektivat kryesore të Platformës janë parandalimi, kryesisht përmes zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, paralajmërimin të hershëm, veprimin në kushtet e fatkeqësive, zvogëlimit të pasojave të fatkeqësive dhe veprimeve pas fatkeqësive.

3.2.2. Korniza institucionale për ndryshimin klimatik në vend

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor i është organi kryesor qeveritar përgjegjës për zhvillimin e politikave lidhur me ndryshimet klimatike. Brenda strukturës së Ministrisë, emërohet *një Pikë kombëtare për kontakt për Konventën kornizë të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike dhe Institucioni nacional i caktuar për zbatimin e Protokollit të Kiotos* dhe ata janë përgjegjës për koordinimin e zbatimit të dispozitave përkatëse të Konventës

⁸⁹ Ibid. f.17.

⁹⁰ <https://tinyurl.com/6chdm2c2>

dhe Protokollit. Ministritë e tjera kryesore, organet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë detyrime në zbatimin e këtyre politikave. Disa prej tyre caktojnë pika të kontaktit ose komisione të brendshme për fushën e tyre të kompetencës, p.sh. *Ministria e punës dhe politikës sociale - Konventa kornizë e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, gjininë dhe ndryshimet klimatike, pika për kontakt, Ministria e shëndetësisë – Komiteti kombëtar për ndryshimet klimatike dhe shëndetin*, etj. Në nivel kombëtar, në kuadër të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, është krijuar një Komitet kombëtar për ndryshimet klimatike si një platformë shumë-sektoriale për mbështetje dhe udhëzime të nivelit të lartë për zbatimin e përgjithshëm të politikës së ndryshimeve klimatike, por nuk është plotësisht funksional.

3.2.3. Korniza institucionale për menaxhimin e tokës, planifikimin hapësinor dhe urban

Ministria e transportit dhe lidhjeve është organi kryesor qeveritar përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe rregullave të menaxhimit të tokës/planifikimit hapësinor dhe urban. *Agjencia për planifikim hapësinor* është përgjegjëse për zbatimin e politikave të përgjithshme të planifikimit dhe politikës së përgjithshme hapësinore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3.2.4. Korniza institucionale e sistemit të gjithëpërfshirjes së aftësisë së kufizuar

“Ministria e punës dhe politikës sociale konsiderohet të jetë ofruesi kryesor i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara pasi që shumica e organeve përgjegjëse për çështjet që kanë të bëjnë me aftësitë e kufizuara punojnë nën ombrellën e kësaj ministrie.”⁹¹ Ajo ka përgjegjësinë kryesore për krijimin dhe zbatimin e politikave për avancimin e agjendës së gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Në kuadër të strukturës së zyrës së Kryeministrit, *Trupi koordinues kombëtar për zbatimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara* funksionon si një organ që bashkon punën e aktorëve të ndryshëm kryesorë në lidhje me përmbushjen e konventës që synon avancimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara. Në *zyrën e Avokatit të Popullit*, në kuadër të Departamentit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, ekziston një ekip për monitorimin e zbatimit të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. *“Ekipi punon në rastet e shkeljes së të drejtave dhe diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar, si dhe në analizën e legjislacionit dhe propozimin e reformave ligjore në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.”*⁹² Në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, është themeluar *Grupi ndërparlamentar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara* për të avokuar për rritjen e kornizës normative të personave me aftësi të kufizuara. *Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi* është një subjekt i pavarur që mbulon 19 baza të përcaktuara për diskriminimin gjinor, racën, ngjyrën, gjininë, përkatësinë në një grup të marginalizuar, përkatësinë etnike, gjuhën, shtetësinë, origjinën shoqërore, fenë ose besimin, arsimin, përkatësinë politike, statusin personal ose social, aftësinë e kufizuar mendore ose fizike, moshën, statusin familjar

⁹¹ Organizata e Kombeve të Bashkuara, Maqedonia e Veriut, UNPRPD. *Analiza e situatës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut* – 2021. 2022. f. 10. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/mry7bf3j>

⁹² Organizata e Kombeve të Bashkuara, Maqedonia e Veriut, UNPRPD. *Analiza e situatës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut* – 2021. 2022. f. 10. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/mry7bf3j>

ose martesor, statusin e pronës, shëndetin dhe baza të tjera.⁹³ *Këshilli kombëtar i organizatave për aftësitë e kufizuara të Maqedonisë (KKPI)* është shoqata më e madhe përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e themeluar nga shoqata e organizatave kombëtare të aftësisë së kufizuar për të punuar së bashku për të avancuar të drejtat dhe për të realizuar interesat e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në vend.⁹⁴

⁹³ https://equineteurope.org/author/macedonia_cpd/

⁹⁴ <https://www.nsiom.org.mk/>

4. HENDEQET E SISTEMIT, SFIDAT DHE PRAKTIKAT E MIRA NË PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KORNIZËN KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË

4.1. Hyrje

Në përgjithësi, duke ndjekur pasqyrën e kontekstit aktual dhe kornizat rregullatore dhe arkitekturën institucionale të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirjes së aftësisë së kufizuar, vërehet se integrimi i zvogëlimit të rrezikut dhe përfshirjes së aspekteve të aftësisë së kufizuar është në një fazë shumë rudimentare me vetëm disa referenca të aftësisë së kufizuar në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, politikat e lidhura me shëndetin ose planifikimin hapësinor, zgjidhjet dhe praktikat legislative. Një situatë e ngjashme mund të gjendet në zonën e përfshirjes së aftësisë së kufizuar ku zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë ose ndërtimi më gjithëpërfshirës i rezistencës individuale dhe shoqërore ndaj fatkeqësive dhe krizave nuk njihet si një zonë e rëndësishme për ekzistencën, mirëqenien dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara. *“Hendeqet në lidhje me situatën e personave me aftësi të kufizuara në një kontekst të emergjencave ose krize humanitare janë bërë të dukshme gjatë shpërthimit të pandemisë me KOVID-19. Korniza ligjore ekzistuese për krizat humanitare dhe gjendjen e jashtëzakonshme nuk është i harmonizuar me Konventën e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe nuk parashikon dhe garanton pjesëmarrjen dhe konsultimin me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara.”*⁹⁵ Megjithatë, me miratimin e kornizave globale të zhvillimit të qëndrueshëm dhe elastik ose Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, është e rëndësishme të përforcohet angazhimi për reduktimin gjithëpërfshirës të rreziqeve ekzistuese dhe atyre në zhvillim. Prandaj, duke synuar të profilizojë rrugën e mundshme të zhvillimit të ndërtimit të një shoqërie dhe komuniteteve gjithëpërfshirëse dhe rezistente në vend, kjo pjesë e studimit identifikon boshllëqet dhe sfidat ekzistuese, si dhe pikat e forta dhe praktikrat e mira të cilat përdoren për të formuluar rekomandime dhe veprime vijuese largpamëse. Rishikimi bëhet sipas fazave të ciklit të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe prioriteteteve të Kornizës Sendai, si më poshtë:

⁹⁵ Organizata e Kombeve të Bashkuara, Maqedonia e Veriut, UNPRPD. *Analiza e situatës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2021*. 2022. f. 41. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/mry7bf3j>

Table 3. Struktura e rishikimit të gjithëpërfshirjes së aftësisë së kufizuar në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Rishikimi	Korniza Sendai	Cikli MRF - faza
Terminologjia	Prioriteti 1: Kuptimi i rrezikut	Parandalimi/zbutja
Kornizat politike dhe rregullatore	Prioriteti 1: Kuptimi i rrezikut	Parandalimi/zbutja
Arkitektura institucionale	Prioriteti 2: Rregullimi i rrezikut nga fatkeqësitë	Parandalimi/zbutja
Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara dhe organizimi i tyre	Të gjitha prioritetet	Të gjitha fazat
Praktikat e zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirja e aftësisë së kufizuar	Të gjitha prioritetet	Të gjitha fazat
Mbledhja dhe analiza e të dhënave të ndara për aftësinë e kufizuar	Të gjitha prioritetet	Të gjitha fazat
Qasja në informacionin dhe komunikimin e rrezikut të klimës dhe fatkeqësive	Prioriteti 1: Kuptimi i rrezikut Prioriteti 2: Rregullimi i rrezikut nga fatkeqësitë Prioriteti 4: Rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive dhe "Ndërtimi më i mirë"	Të gjitha fazat
Investime në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, duke përfshirë edhe aftësinë e kufizuar	Prioriteti 3: Investimi në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë	Parandalimi/zbutja Gatishmëria Përgjigje
Rimëkëmbja dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara	Prioriteti 4: Rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive dhe "Ndërtimi më i mirë"	Rimëkëmbja

4.2. Hendeqet dhe sfidat për menaxhimin kombëtar të rrezikut nga fatkeqësitë, duke përfshirë aftësinë e kufizuar

- Terminologjia** – Siç mund të shihet nga analiza e rishikimit të politikave dhe dokumenteve normative të mësipërme, sfida fillestare është terminologjia dhe përcaktimi i kategorisë së aftësive të kufizuara. Ekziston një qasje e ndryshme dhe përkufizime ose kuptime të ndryshme mund të gjenden në dokumente dhe praktika, si në forumin e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë ashtu edhe në forumin e përfshirjes së aftësisë së kufizuar. Duke pasur parasysh të parën, në vend, nuk ka një terminologji të standardizuar për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë sipas terminologjisë së UNDRR-së për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë⁹⁶, dhe si sistemet e menaxhimit dhe mbrojtjes nga krizat dhe shpëtimin kanë një qasje të ndryshme ndaj kësaj çështjeje dhe akti më i avancuar normativ është Rreg-

⁹⁶ <https://www.undrr.org/terminology>

ullorja për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë për Republikën e Maqedonisë nga të gjitha rreziqet, përmbajtja dhe struktura e saj, mënyra e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimi i subjekteve në sistemin e menaxhimit të krizave, të cilave u dorëzohet një deklaratë e plotë ose e plotë nga vlerësimi (2011) nga Qendra për menaxhim me krizat, ku përkufizimet kryesore duke përfshirë rezistencën bazohen në këtë themel terminologjik. Lidhur me këtë të fundit, “ndërsa Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi rregullohet në përputhje me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Kushtetuta dhe korniza ligjore ekzistuese ngarkohen me terminologji nënçmuese, kryesisht duke përdorur qasjen mjekësore ndaj aftësisë së kufizuar. Dallimet brenda vetë komunitetit të aftësisë së kufizuar nuk njihen dhe nuk konsiderohen brenda legjislacionit, strategjive, planeve dhe buxheteve.”⁹⁷

Për më tepër, “përkufizimet e personave me aftësi të kufizuara të përdorura në dokumente të ndryshme nuk janë të unifikuara, ndërsa personat me aftësi të kufizuara psikosociale nuk njihen fare”.⁹⁸ Ky është rasti në kornizën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, ku mund të gjendet identifikimi i ndryshëm terminologjik i personave me aftësi të kufizuara, d.m.th personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, personat me nevoja të veçanta, personat me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar. Përveç kësaj, rëndësia dhe pozicioni i *kujdestarëve*⁹⁹ për personat me aftësi të kufizuara nuk merren parasysh në kornizat terminologjike të të dy fushave.

- **Kornizat e politikave dhe rregullatore** – Analiza e situatës së OKB-së thekson se ekziston një “mungesë e plotë e strategjive të aftësisë së kufizuar dhe integritit të aftësisë së kufizuar në strategjitë ekzistuese të të gjithë bartësve të detyrës.”¹⁰⁰ Në mënyrë të ngjashme, rishikimi i strategjive kombëtare, politikave dhe akteve normative në lidhje me mbrojtjen dhe shpëtimin, si dhe menaxhimin e krizave, shëndetin, ndryshimin e klimës, menaxhimin e tokës/planifikimin hapësinor dhe urban nuk kanë gjetur praktikisht asnjë referencë për aftësinë e kufizuar në dokumentet specifike të vendit me pothuajse asnjë përparim në zbatimin e Kornizës Sendai nga perspektiva e përfshirjes së aftësisë së kufizuar. Përfshirja e aftësisë së kufizuar nuk është pjesë e politikave dhe rregulloreve aktuale për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe korniza ekzistuese mund të etiketohet si përfshirja e aftësisë së kufizuar “e verbër”. Në veçanti, Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara nuk është e integruar, veçanërisht neni 4 i cili kërkon që legjislacioni kombëtar për reagimin ndaj emergjencave dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe politikat e tyre përkatëse të jenë në përputhje me Konventën. Ky integrim i pamjaftueshëm u identifikua në *Komitetin e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Raportin fillestar të vendit për zbatimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në vitin 2018*, ku u deklarua qartë se Komiteti ishte i shqetësuar për mungesën e përfshirjes së perspektivave në lidhje me aftësinë e kufizuar, qasjen dhe mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara në Drejtorinë kombëtare të mbrojtjes dhe shpëtimit, dhe mungesën e num-

⁹⁷ Organizata e Kombeve të Bashkuara, Maqedonia e Veriut, UNPRPD. *Analiza e situatës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2021*. 2022. f. 6. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/mry7bf3j>

⁹⁸ Ibid.f.13.

⁹⁹ “Kujdestarët janë njerëz që kujdesen për të rriturit e tjerë, shpesh prindërit ose bashkëshortët, ose fëmijët me nevoja të veçanta mjekësore. Disa kujdestarë janë anëtarë të familjes; të tjerët paguhen.” Në dispozicion në: <https://www.disabled-world.com/disability/caregivers/>

¹⁰⁰ Organizata e Kombeve të Bashkuara, Maqedonia e Veriut, UNPRPD. *Analiza e situatës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2021*. 2022. f. 31. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/mry7bf3j>

rave të urgjencës në formate të arritshme, pajisje të arritshme dhe sigurimin e kurseve të trajnimit të urgjencës dhe shpëtimit për personat me aftësi të kufizuara.¹⁰¹ Rrjedhimisht, rekomandimi për politikën dhe kornizën rregullatore ishte rishikimi i legjislacionit, politikave dhe udhëzimeve për të siguruar që menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndihma humanitare të jenë të arritshme për personat me aftësi të kufizuara.¹⁰² Për më tepër, *“korniza ligjore për krizat humanitare dhe emergjencat nuk është në përputhje me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në situatën e pandemisë, njerëzit me aftësi të kufizuara u marginalizuan përsëri, pasi nevojat e tyre specifike nuk u trajtuan në mënyrë të përshtatshme.”*¹⁰³

